

BARKODI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS
AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE 2013

LËNDA: LETËRSI E THELLUAR

VARIANTI **A**

E shtunë, 29 qershor 2013

Ora 10.00

Udhëzime për nxënësin

Testi në total ka **20** pyetje.

Në test ka kërkesa me **zgjedhje** dhe me **zhvillim**.

*Në kërkesat me zgjedhje rrethoni **vetëm** shkronjën përbri përgjigjes së saktë, ndërsa për kërkesat me zhvillim është dhënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.*

Pikët për secilën kërkesë janë dhënë përbri saj.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Kërkesa	1	2	3	4	5	6	7	8
Pikët								
Kërkesa	9	10	11	12	13	14	15	16
Pikët								
Kërkesa	17	18	19a	19b	20a	20b	20c	20d
Pikët								

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.Anëtar

PJESA I**Sabri Godo***Skënderbeu (fragment)*

Lekë Dukagjini vraponte për të arritur në Lezhë po natën e fitores. Frynte një erë e huaj, që të hynte në kockë, e përcjellë nga gjëmime. Pastaj nisi një shi i imët me dëborë. Errësira u trazua me avuj që shfrynin nga të gjitha anët. Leka vraponte pa u ndalur nëpër kalldrëmin që ndriçohet nga vetëtimat. Ndihej i çliruar nga ambicia, që e kishte munduar tërë jetën dhe dukej sikur përpiqej të shihte në errësirë atë që po ndodhte brenda tij. Ambicia dhe krenaria e pakufishme kishin qenë tek ai po aq të thella se edhe fryma dhe tani ato ishin shkukur dhe ai ndihej ende i shqetësuar nga kjo gjendje e re. Ishte sikur t'i kishin ndërruar gjakun dhe ai donte të mendohej në errësirë, po një mendim i dytë ia nxehte trupin valë dhe, që të qetësohej, ia kthente fytyrën thëllimit të Veriut. Ky Leka tjetër ishte i pushtuar nga ndjenja e një katastrofe të afërt. Ai mbërthehej në shalën e kalit dhe e përdorte kamxhikun pa mëshirë. Kali me veshët të ngjitur pas kokës, nxinte dhe çante përpara me një shpejtësi të verbër. Por, sa më tepër vraponte kali, aq më tepër i rritej Lekës shqetësimi. Katastrofa e pashembullt do të ngjante sikur të mos vraponte edhe më. Kjo ndjenjë e kishte zotëruar nga flokët te thonjtë e këmbëve, që në çastin kur u shemb përtokë Ahmet pasha. Pak nga pak, në vrap e sipër, katastrofa që rëndonte mbi qiell e mbi tokë, po merrte formën e një objekti të prekshëm. Ajo kishte lidhje me një rënie tjetër. Lekës i shtrëngohej zemra dhe nuk arrinte të kuptonte se ç'po ngjiste me të. Nga po vinte kjo përmbysje e zezë? Ai nuk donte të mendonte më mbi të. Lëpinte dëborë dhe i thërriste kalit që të nxitonte sa më shumë për t'i dhënë Skënderbeut lajmin e fitores, krejt i sigurt se më këtë fjali të vetme do ta çonte nga shtrati. Leka do ta vriste me duart e tij atë njeri që do ta pengonte në rrugë ose që do të shfaqte një besim të kundërt. Pastaj ai do të shkonte përsëri në luftë dhe faqe gjithë botës do ta shpallte Skënderbeun “babë” dhe “zotin e madh të Dukagjinit”.

Po a do të çohet menjëherë Skënderbeu?

Gjatë tri ditëve, Lekës nuk i shqitej nga sytë buzëqeshja e madhe e Skënderbeut, kur u ngrit përgjysmë nga shtrati dhe i uroi rrugën e mbarë.

Leka thirri në errësirë: “Hej, më shpejt, përpara, më shpejt” dhe rojet që vraponin pas tij i dërrmuan kuajt në kalldrëmin e vjetër. Tërbimi i Lekës kishte nisur menjëherë pas luftës dhe rojet nuk e kuptonin shkukur, por ata e dinin se Leka nuk i falte vonesat dhe s'e njihte mëshirën dhe rendnin pas tij, të bindur se ai nuk do të ndalej atë natë pa e thyer kokën.

Leka arriti në Lezhë në agim. Skënderbeu kishte vdekur tri orë më parë. Leka u përmbajt dhe lëvizti në heshtje, kur ra më gjunjë dhe i puthi të vdekurit dorën, kur ngushëloi Donikën dhe i mori Gjonit kokën në gjoks.

Thëllimi kishte pushuar. Dëbora e pakët zbardhte ende në çatitë dhe tretej me shpejtësi. Kullonin strehët. Kur doli Leka në krye të tregut, pëshpëritjet lajmëruan arritjen e tij. Ishte e para pëshpëritje e turmës, miqësore dhe e dalë nga zemra. Turma ngriti fytyrat me shpresë, sikur njeriu që po vinte do ta bënte vdekjen të paqenë, dhe priti e ndehur një fjalë prej tij.

Lekës i rritej pikëllimi. Ai ndaloi në mesin e tregut, pa shikuar asnjëri. Hoqi gunën ngadalë dhe e la përtokë. Pastaj shkopsiti gjoksin. Furia e tri ditëve të fundit po i shpërthente njëherësh atje në mes të njerëzve, ai e dinte se tani ishte i pushtuar i tëri prej saj dhe s'mund të bënte asgjë për ta ndalur, veç të kryente ngadalë lëvizjet. Ai ra më gjunjë dhe filloi të shkulte mjekrën, me rënkime, sikur po nxirrte shpirtin. Pastaj u çua, eci shtrembër dhe përsëri ra më gjunjë, ndërsa i shtohet gulçimi dhe kapte gjoksin me duar si i përvëlur nga plagë të padukshme. Kjo ishte një pamje që s'mund të durohej, por askush nuk merrte guximin të afrohej për ta ndalur ose për ta ndihmuar. Askush s'kishte parë ndonjëherë në Shqipëri një vaj të tillë. Mendjen e njerëzve filloi ta pushtonte mendimi se vdekja e asaj dite ishte vdekja e gjithkujt. Leka qëndroi më gjunjë më në fund dhe nisi një vajtim të rregullt, i mbuluar me lot, duke shkukur ngadalë mjekrën dhe flokët dhe thoshte se kishte vdekur “baba”. Atëherë njerëzit u kujtuan se ai duhej të ishte një vajtim i motshëm. Ushtarët filluan të binin më gjunjë dhe nisën vajin pranë Lekës. Pastaj ranë më gjunjë me ndrojtje dhe nisën vajin qytetarët.

Për pyetjet nga 1 deri në 5 rrethoni alternativën e saktë.

1. Romani “Skënderbeu” vlerësohet si roman historik, pasi: **1 pikë**
- A) i qëndron besnik fakteve dhe të vërtetave historike.
 B) interpreton disa të vërteta të panjohura nga historianët.
 C) nuk i ruan raportet kronologjike shkak-pasojë në dobi të frymës romaneske.
 D) është tekst i shkruar me qëllim përdorimin dhe analizën e argumentit historik.
2. Në këtë fragment autori thekson tek Lekë Dukagjini: **1 pikë**
- A) aftësinë e tij si strateg i luftës me turqit.
 B) anën e tij të ndjeshme njerëzore.
 C) autoritetin e tij të padiskutueshëm tek ushtria.
 D) shpirtin e paepur të luftëtarit.
3. Në cilën prej alternativave të mëposhtme është përdorur metafora? **1 pikë**
- A) Lekës i rritej pikëllimi.
 B) Lekë Dukagjini vraponte për të arritur në Lezhë po natën e fitores.
 C) Leka do ta vriste me duart e tij atë njeri që do ta pengonte në rrugë.
 D) Askush s’kishte parë ndonjëherë në Shqipëri një vaj të tillë.
4. Kur autori thotë: *Ky Leka tjetër ishte i pushtuar nga ndjenja e një katastrofe të afërt me fjalën katastrofë* ai nënkupton: **1 pikë**
- A) humbjen te Leka të krenarisë dhe ambicies;
 B) pushtimin e afërt të Shqipërisë;
 C) rënien e Lezhës në duart e turqve;
 D) vdekjen e Skënderbeut.
5. Rrëfimi në këtë fragment ndërthur: **1 pikë**
- A) dialogun me monologun.
 B) përshkrimin me rrëfimin.
 C) analizën me dialogun.
 D) përshkrimin me dialogun.
6. Cilat janë dy karakteristika të Lekës, të cilat ushtarët ia njohin mjaft mirë? **2 pikë**
- a) _____ b) _____
7. Zbuloni dy nga arsytet që e shtyjnë Lekën të nxitojë drejt Lezhës. **2 pikë**
- a) _____ b) _____

8. Identifikoni në këtë fragment dy elemente të jetës zakonore shqiptare.

2 pikë

a) _____

b) _____

9. A mendoni se vdekja e Skënderbeut merr përmasa të jashtëzakonshme? Argumentoni mendimin tuaj.

2 pikë

10. Nisur nga fragmenti, shpjegoni pse kjo është një vepër historiko-letrare. Mendimin tuaj ilustroni me shembuj nga pjesa.

4 pikë

PJESA II**Kadare***Darka e gabuar (fragment)*

Duke zbritur thellë e më thellë në kohë, disa u kujtuan për darkën e Krishtit, siç tregohej në shkrimet e shenjta, të sigurt se atje do të gjenin më në fund enigmën. Ishin të gjithë në atë darkë; Krishti vetë me pikëllimin e tij hyjnor, apostujt, madje e dhe Juda Iskarioti. Kështu u duk se po gjenin të vërtetën, por shi atëherë ajo nisi të fironde. Që s'ishte Krisht, doktor Gurametoja, e aq më pak mysafirët gjermanë, kjo dukej që larg, por edhe Judë t'i quaje ishte e tepërt. Duke psherëtirë e duke u lutur: falna, Zot, këto lajthitje të mendjes, rrekeshin të hiqnin dorë nga çdo mendim.

Në lagjet më të largëta, atje ku shtëpitë ishin më të vetmuara, ngaqë lajmet e reja arrinin më vonë, donin s'donin, kënaqeshin me të vjetrat.

Pikërisht në njërën nga shtëpitë e vetmuara, u kujtua një darkë e moçme, e njohur brez pas brezi si gojëdhënë apo ninull për të vënë fëmijët në gjumë, ajo ku rrëfehej se si i zoti i shtëpisë, në detyrim të një pakti, sipas të cilit duhet të ftonte për darkë një të panjohur, ia kishte dhënë ftesën të birit, bashkë me porosinë. Dhe i biri tek ecte rrugës për të gjetur kalimtarin e panjohur, i trembur prej shkretisë së rrugës e kishte hedhur ftesën në varreza. Qe kthyer në shtëpi, për t'i thënë t'et: e kreu porosinë, zoti tatë, në kohën që te dera qe shfaqur i vdekuri me ftesën në dorë, duke tmerruar darkëtarët e të zotin e shtëpisë: më ftove, ja ku erdha, mos më vështro ashtu!

Për pyetjet nga 11 deri në 15 rrethoni alternativën e saktë.

11. Në fragmentin e mësipërm ndërthuret:

1 pikë

- A) legjenda me historinë;
- B) fantazia me historinë;
- C) realiteti me fantazinë;
- D) legjenda me shkrimet biblike.

12. Në fund të fragmentit, nga fjalët e të vdekurit, përftohet figura e:

1 pikë

- A) alegorisë;
- B) metaforës;
- C) personifikimit;
- D) simbolit.

13. Cila është fjala kyç për të dy darkat: darkën e Krishtit dhe darkën e gabuar të Kadaresë?

1 pikë

- A) enigmë;
- B) hyjnore;
- C) e moçme;
- D) mitike.

14. Romani “Darka e gabuar” është në një linjë vazhdimi me romanin: **1 pikë**

- A) E penguara;
- B) Kështjella;
- C) Kronikë në gur;
- D) Gjenerali i ushtrisë së vdekur.

15. Në fjalinë *Kështu u duk se po gjenin të vërtetën, por si atëherë ajo nisi të fironte fjala fironte* ka kuptimin: **1 pikë**

- A) largohej;
- B) shfaqej;
- C) kuptohej;
- D) humbiste.

16. Analizoni një nga veçoritë kryesore të rrëfimit në këtë fragment. **2 pikë**

17. Në baladat legjendare popullore gjejmë shpesh raste të *detyrimit ndaj një pakti* (fjala e dhënë). Identifikoni dy prej tyre. **2 pikë**

18. Si e kuptoni titullin e romanit? Për kë ishte e gabuar kjo darkë? **2 pikë**

19.

a) Identifikoni në fragment një element biblik, një legjendar dhe një historik. **3 pikë**

b) Çfarë simbolizon figura e Krishtit dhe e Judës në këtë fragment? Çfarë domethënie merr ky përdorim në roman? **3 pikë**
